Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
Datë: 28.02.2023
Nr.RN00011125

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 7 të Rregullores (QRK) nr. 05/2022 për procedurat konkurruese dhe pranimi për nëpunësit administrativ dhe mbështetës, dhe kërkesës së Drejtorisë për Arsim, Komuna e Prizrenit, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS (ME KOHË TË PA CAKTUAR)

1. Titulli i vendit të punës: Punëtor teknik
Numri i Pozitave: 15
Në shkollat:
SHFMU "Lekë Dukagjini" në Prizren – 2 pozita
SHFMU "Dëshmorët e Zhurit" në Zhur
SHFMU "Zef Lush Marku" në Caparc
SHFMU "Motrat Qiriazi" në Prizren
SHFMU "Mustafa Bakiu" në Prizren
SHMLE "Ymer Prizreni" në Prizren
Gjimnazi "Remzi Ademaj" në Prizren
SHFMU "Mushnikova" në Mushnikovë
Çerdhen në lagjen "Bajram Curri" në Prizren – 6

Lloji i Zyrtarit Publik: Nëpunës administrativ dhe mbështetës
Lloji i vendit të punës: me afat të pacaktuar, me orar të plotë (periudha provuese 6 muaj)

Detyra dhe përgjegjësitëpër punëtorë teknik:

-Pastrimi dhe mirëmbajtja e të gjitha ambienteve të shkollës;
-Kujdesi ndaj inventarit të shkollës;
-Dhe detyra të tjera të caktuara nga Drejtori ose sekretari shkollës;

2. Titulli i vendit të punës: Fokist
Numri i Pozitave: 4
Në shkollat:
SHFMU "Hysen Rexhepi" në Prizren
SHFMU "Zenun Çoçaj" në Gjonaj
SHFMU "Nazim Buduri" në Hoçë të Qytetit
Çerdhen në lagjen "Bajram Curri" në Prizren

Detyra dhe përgjegjësitë për fokist:

-Mirëmbajtja e ngrohjes qendrore gjate stinës së dimrit;
-Sigurimi i ngrohjes qendrore dhe funskionimi i saj;
-Kryerja edhe e punëve tjera tëcaktuara nga drejtori gjatë stinës së verës ose dimrit brenda orarit.

Kushtet: Diplomë të shkollës së mesme

Dokumentacioni i kërkuar:

- Formulari i aplikimit i plotësuar;

- Diploma mbi kualifikimin e noterizuar;

- Diplomat e lëshura nga Institucionet Shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara (kopje);

- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) kopje;

- Çertifikata dhe trajnime në qoftë se posedon.

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Konkursi do të jetë i hapur 8 ditë kalendarike, e drejta për aplikim fillon nga data 15.03.2023 deri më datën 22.03.2023 që konsiderohet si dita e fundit dhe mbyllja e konkursit. Aplikimet e dorëzuara pas afatit të parashikuar nuk pranohen dhe aplikimet me mangësi refuzohen. Udhëzime për aplikimin: Kërkesa (Aplikimi) për punësim gjendet në https://kk.rksgov.net/prizren/category/konkurset-njoftimet/aplikacione/ si dhe në https://konkursi.rksgov.net/jobs?servant=2 . Pas plotësimit sipas çdo pike të aplikimit, bashkëngjitni dokumentet të cilat kërkohen sipas konkursit dhe mund të aplikoni në Sportelin nr. 2, rr. “Remzi Ademaj” pn. në Administratën Komunale të Komunës së Prizrenit . VËMENDJE: Aplikimet e pranuara pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar brenda afatit për dorëzimin e aplikimeve. Konkursi është i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu siç parashikohet nga Ligjislacionin në fuqi. Konkursi dhe rezultatet shpallen në web faqen e Komunës së Prizrenit.

Komuna e Prizrenit